



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 579, datë 12.10.2023

PËR EMËRIMIN GJYQATAR TË Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, , i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin nr.402, datë 18.07.2023, “Për kualifikimin për emërim të kandidatit të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...}”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Të emërojë gjyqtar z. {...}.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR